

Propozim:

Në bazë të nenit 8, 9, 11 dh 36 të Ligjit për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.13/06-55/16) dhe në bazë të nenit 26 të Statutit të NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup, Këshilli drejtues i NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup në seancën e mbajtur më datën 08.02.2019 solli këtë:

VENDIM

për përcaktim të listës së informacioneve me karakter publik si dhe përcaktimi i personit zyrtarë për ndërmjetësim gjatë realizimit të së drejtës për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik

Neni 1

Përcaktohet lista e informacioneve me karakter publik, me të cilët disponon NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup:

- 1.Statuti i NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup;
- 2.Vendimi për themelim të NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup;
- 3.Çmimoret e shërbimeve dhe aktiviteteve të punës, të NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup;
- 4.Ligji për ndërmarrjet publike;
- 5.Ligji për gjelbërimin publik;
- 6.Ligji për veprimtaritë komunale;
- 7.Vendimi për rendin komunal i Qytetit të Shkupit;
- 8.Plani vjetor për furnizime publike;
- 9.Vendimi për miratim të PVFP;
- 10.Programi vjetor për mirëmbajtje, shfrytëzim dhe ngritjen e sipërfaqeve të gjelbërimit publik në territorin e Qytetit të Shkupit;
- 11.Raporte vjetore për punën e NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup;
12. Raporte katër mujore për punën e NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup;
13. Rregulla për rendin dhe disiplinën e punës;
14. Harta e sistematizimit të vendeve të punës;
15. Programi për investime i NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup.

Neni 2

Lista e informacioneve me karakter publik me të cilët disponon NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup, shpallet në ueb faqen e NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup.

Neni 3

Drejtori i ndërmarrjes me vendim përcakton personin (personat) zyrtarë për ndërmjetësim me informacionet.

Neni 4

Poseduesi i informacioneve, kërkuesit të informacionit për shkresat e dhëna, fotokopjet ose regjistrimet elektronike të informacionit, nuk i kërkon pagesë të kompensimit për shpenzimet materiale, nëse informacioni përfshin deri më 20 faqe, dhe në rastet kur i njëjti përfshin më shumë se 20 faqe, atëherë realizohet pagesa përkatëse në pajtim me Vendimin me nr. 19-6310/1 të datës 24.12.2006, të miratuar nga Qeveria e RM-së.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Arsyetim

Në pajtim me nenin 9 të LQLIKP, poseduesi i informacioneve është i detyruar që me rregull dhe në mënyrë të azhurnuar të drejtojë listën e informacioneve dhe ti publikojë në mënyrë të qasshme para opinionit (faqes së internetit, në tabelën e kumtesave dhe etj.).

Në pajtim me nenin 8 të LQLIKP, poseduesi i informacioneve është i detyruar që të përcaktoj një ose më shumë persona për ndërmjetësim me informacionet.

Në bazë të lartpërmendurës, u miratua vendimi sikur në dispozitivin.

D.D.

- arkivi
- përfaq. të KD
- drejtori
- shërbimet profesionale

**NP "PARQE DHE GJELBËRIME"
KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES**

Daniella Nikollova